Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**18.05.2020, Prishtinë,**
**Ref:18.12.2019\933-2020**

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Kallxo.com kundër Zëri.info**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij online të mbajtur më 8 maj 2020, shqyrtoi ankesën e Kallxo.com kundër Zëri.info lidhur me artikullin me titull: "Kandidati për deputet: Homoseksualët nuk i mbështes se ata kanë nevojë për ndihmën e mjekëve", dhe mori këtë:

V E N D I M

- Ankesa miratohet.

A R S Y E T I M I

Ankuesi pretendon se media Zëri.info ka publikuar shkrimin i cili më parë ka qenë i shkruar në Kallxo.com dhe se shkrimi është pronësi e tyre. Tutje ankesa dëshmon që media në fjalë nuk ka leje nga ankuesi për publikimin e shkrimeve të tyre me çka ka shkelur edhe Kreun XI (Të drejtat e autorit) të Kodit të Mediave të Shkruara.

Lajmi është shkruar në media të shkruar dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të artikullit dhe shqyrtimit të ankesës, KMShK gjen se ankesa miratohet.

Për shkak se ankuesi ka të drejtën e plotë që të mbrojë shkrimet e tij dhe rrjedhimisht Ligji por edhe Kodi i mediave të shkruara në Kreun XI ka paraparë që media duhet të marr leje për të ripublikuar një shkrim autorial të një media tjetër.

KMShK pas analizimit të provave të dorëzuara dhe shkrimit të botuar, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**